



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTER
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4370 Regj.

Ballsh, më 21.12.2021

VENDIM

Nr 60 Dt. 20.12/2021

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2022-2024 DHE TË BUXHETIT VJETOR 2022**

Këshilli i Bashkise Mallakastër ne mbledhjen e datës 20.12.2021 pasi u njoh me projekt vendimin e përgatitur nga Drejtoria Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale për kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe buxhetin vjetor 2022", në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8, neni 9, neni 41, neni 54, neni 64 gërma "c" dhe Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33:

VENDOSI:

1. Të miratoj kalendarin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe buxhetit vjetor 2022.
2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendim ngarkohet Grupi per Menaxhim Strategjik.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 (dhjetë) ditë pas miratimit.

Kryetari i Këshillit

Mbarime ISUFAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTER

KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM(2022-2024) DHE
BUXHETIT VJETOR

Nr	Aktiviteti	Struktura përgjegjëse	Afati
1	Paraqitja për shqyrtim e miratim të Raportit për Vlerësim e Parashikimeve Afatmesëm të të Ardhurave	Drejtoria Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale	31 Janar 2022
2	Miratim nga Këshilli Bashkiak i Raportit për Vlerësim e Parashikimeve Afatmesëm të të Ardhurave .	Këshilli i Bashkisë	01 Mars 2022
3	Përgatitja e tavaneve të shpenzimeve të PBA-së 2019-2021 nivel programi. Diskutimi në takimin e GMS	GMS dhe EMP	10 Mars 2022
4	Miratimi i tavaneve të shpenzimeve të buxhetit afatmesëm PBA 2019-2021	Këshilli i Bashkisë	15 Mars 2022
5	Përgatitja dhe miratimi i udhëzimit të përgatitjes së PBA-së dhe Buxhetit Vjetor.	Këshilli i Bashkisë (Dr.Ekonomike ,GMS , EMP)	10 Prill 2022
6	Plotësimi i kërkesave buxhetore të konsoliduara për çdo program dhe kërkesave shpesh sipas programeve nga drejtuesit e EMP-ve.	EMP-të dhe Drejtoritë	05 Maj 2022
7	Vlerësimi dhe miratimi nga GMS-ja i kërkesave buxhetore.	GMS dhe EMP	15 Maj 2022
8	Hartimi i draft-dokumentit të PBA 2019-2021. Diskutimi në takimin e GMS. Dërgimi në MF i draft PBA-së.	Kryetari i Bashkisë GMS	01 Qershor 2022
9	Shqyrtimi dhe miratimi nga këshilli Bashkiak i draft PBA-së , duke u njohur edhe me rekomandimet e MF.	Këshilli Bashkiak	30 Qershor 2022
10	Dërgimi me shkrim dhe elektronikisht i PBA-së së miratuar nga këshilli në MF.	Kryetari i Bashkisë GMS	30 Qershor 2022

11	Publikimi i dokumentit të PBA-së të miratur.	Kryetari i Bashkisë GMS	05 Korrik 2022
12	Përgatitja e udhëzimit për përgatitjes e Buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe shpërndarjen tek Njësitë Shpenzuese : a.tavanet përfituese b.afatet e përgatitjes së kërkesës të rishikimit të PBA-së 2019-2021.	Kryetari i Bashkisë GMS	25 Korrik 2022
13	Përgatitja e projektit të rishikuar të PBA-së 2019-2021. Organizimi i seancave dëgjimore me komunitetin (Nj. Administrative , Lagjet e Qytetit, Grupet e interesit, shoqëria civile). Hartimi i planit të masave dhe veprimit për organizimin e dëgjësive publike për PBA-në .	Kryetari i Bashkisë GMS	Gusht-Shtator 2022
14	Miratimi i PBA të rishikuar në Këshillin Bashkiak Njohja e Këshillit me rekomandimet e dhëna nga MF.	Këshilli Bashkiak	15 Shtator 2022
15	Zhvillimi i seancave të konsultimit dhe reflektimi i sugjerimeve në dokumentin final të PBA-së.	Kryetari i Bashkisë GMS	5 Tetor 2022
16	Pas miratimit të PBA-së të rishikuar përgatitja e Projekt Buxhetit Vjetor , parashikimi për çdo zë të ardhur dhe shpenzimi: - Për çdo program. - Për çdo Njësi shpenzuese.	Drejtoritë e Bashkisë	30 Nëntor 2022
17	Miratimi nga Këshilli Bashkiak i Buxhetit Vjetor dhe i PBA përfundimtare 2019-2021	Këshilli Bashkiak	25 Dhjetor 2022
18	Dërgimi i një kopjeje të Buxhetit Vjetor dhe i PBA-së përfundimtare 2019-2021, në Ministrinë e Financave.	Sekretari GMS	5 ditë nga data e miratimit
19	Publikimi i Buxhetit Vjetor dhe i PBA përfundimtare së bashku me dokumentacioni shoqërues: - Në faqen zyrtare të Bashkisë - Buletini e Njoftimeve Publike	Spektori i Burimeve Njerëzore	5 ditë pas miratimit nga Këshilli Bashkiak

Kryetari i Këshillit

Mbarime ISUFAJ

